



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9097/2 Prot

Fier, më 22.07.2026

V E N D I M

Nr. 61, datë 22.07.2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË FIER PËR
PERIUDHËN 2026-2029**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a", pikës 1, të nenit 28, gërmës "a", të pikës 2, të nenit 33, të gërmës "k", të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Ligji Nr. 9131/2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike", Ligji Nr. 23/2026 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit; Metodologjisë Standarde për Hartimin e Planeve të Integritetit në Nivel Vendor, miratuar nga Ministria e Drejtësisë;

Ligjin nr.114/2024 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin, 'Bashki të Forta (BTF), Faza 2', si dhe urdhërit të Titullarit me nr. 6392 datë 20.05.2026, « Për ngritjen e Grupit të punë për hartimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Fier për periudhën 2026-2029 », Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Fier për periudhën 2026-2029, sipas materialit të përgatitur nga Grupi i Punës, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit do të jetë Koordinatori i Integritetit në Bashki i cili ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, veçanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit të Bashkisë së Fier, për veprime që mund të ndodhin dhe mund të çojnë në cënimin e integritetit të Institucionit.
3. Koordinatori i Integritetit në Bashki ngarkohet të raportojë periodikisht çdo 6 muaj përpara Këshillit Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit të masave.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) dite pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Melsi Bogdani

